

VENDIM
Nr.20, datë 10.12.2009

**PËR PËRCAKTIMIN E MASËS SË PËRFITIMIT FINANCIAR MUJOR PËR
SHËRBIMIN E TRANSPORTIT TË DEPUTETËVE**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, të nenit 2 pika 2 të ligjit nr.10 160, datë 15.10.2009 “Për rregullimin e shërbimit të transportit për funksionarët publikë dhe nëpunësit civilë”, si dhe të nenit 55 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e deputetëve Viktor Gumi, Gent Strazimiri, Florian Mima dhe Paulina Hoti,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Masa e përfitimit financiar mujor për çdo deputet për shërbimin e transportit përcaktohet sipas lidhjes bashkëngjitur këtij vendimi.

II. Në vendimin e Kuvendit nr.68, datë 20.2.2003 “Për mënyrën e trajtimit të deputetëve”, i ndryshuar:

1. Pikat V dhe VI shfuqizohen.

2. Në pikën VIII fjalët “dhe V”, si dhe fjalia “Pagesa e llogaritur sipas pikës VI jepet në të njëjtën mënyrë çdo tre muaj”, shfuqizohen.

III. Në ushtrim të mandatit, deputetëve të legjislaturës XVIII u rimburohen shpenzimet financiare të karburantit për periudhën 7 shtator 2009 deri më 20 nëntor 2009. Masa e rimbursimit përcaktohet duke marrë në konsideratë një mesatare, sipas qarqeve ku janë zgjedhur.

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet financiare prej datës 20.11.2009.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

**MASA E PËRFITIMIT FINANCIAR MUJOR PËR SHËRBIMIN E TRANSPORTIT TË
DEPUTETËVE**

Lekë				
Nr.	Zonat	Nr.dept.sipas zonave	Vlera mujore/lekë	Gjithsej
1	Tirana	32	37,000	1,184,000
2	Durrësi	13	37,000	481,000
3	Lezhë	7	40,000	280,000
4	Elbasani	14	42,000	588,000
5	Dibra	6	57,000	342,000
6	Vlora	12	55,000	660,000
7	Shkodra	11	49,000	539,000
8	Fieri	16	45,000	720,000
9	Berati	8	45,000	360,000
10	Kukësi	4	56,000	224,000
11	Korça	12	53,000	636,000
12	Gjirokastra	5	57,000	285,000

	Totali	140		6 299 000